



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENSIA KOMBETARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË
SHKOLLA 12-VJECARE PRIVATE “ ELITË”

RREGULLORE E BRENDSHME PËR SISTEMIN E VËZHGIMIT ME KAMERA (CCVT)

Shkolla 12 vjecare “Elite “ përdor sistemin e saj të mbikëqyrjes video (CCTV).

Për vetë llojin e aktivitetit të shkollës e ka të domosdoshme survejimin e ambienteve të saj, me qëllimin kryesor sigurinë e nxënësve, personelit, mbrojtjen e pronës, aseteve, vizitoreve dhe kontrollit të hyrje-daljes në ambientet e saj.

Sistemi i mbikëqyrjes me video ofron siguri dhe ndihmon në parandalimin, pengimin dhe zbulimin e çdo aksesit fizik të paautorizuar, duke përfshirë zonat e vendosura nën mbikëqyrje ose mbrojtje, infrastrukturë IT ose informacion operacional, në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e ngjarjeve të rrezikshme për nxënësit, vjedhjes së pajisjeve ose pronës që i përket kompanisë, nxënësve, vizitorëve ose stafit të saj ose veprimeve që kërcënojnë sigurinë në mjediset e shkollës.

Baza ligjore:

- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr.9887, date 10.03.2008
- Udhëzim nga ministria e brendshme nr.134, date 10.03.2017, për përcaktimin e masave shtesë të sigurisë,
- Udhëzimi nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndertesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 46, date 28.3.2017 Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Kamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë, por janë programuar që të regjistrojnë vetëm në momentet që ka lëvizje:

- Hyrjen e shkollës dhe oborrin përpara dhe pas godinës së shkollës.
 - Korridoret e brendshme të shkollës
 - Mjediset e klasave dhe palestra
 - Hyrjen e sekretarisë, drejtorise
-
- Kamerat regjistrojnë vetëm imazhet që kanë lidhje me qëllimin për të cilin sistemi CCTV është miratuar dhe instaluar.
 - Në çdo zonë ku janë të instaluar kamera vëzhgimi, është vendosur njoftimi në zonë të dukshme nga të gjithë, sipas aneksit të aprovuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Në ambientet e drejtorisë së shkollës ku janë vendosur këto pajisje lejohet hyrja dhe përdorimi vetëm nga personi i autorizuar nga administratori i shkollës që është drejtorja e shkollës Jetmir Alicka dhe Nëndrejtoresha Vjola Zhuli.
 - Akseset e pamjeve të regjistruara është i kufizuar vetëm për personin e autorizuar. Të gjitha akseset ose shikimet e pamjeve të regjistruara ndodhin vetëm brenda nje ambienti të përcaktuar dhe pjesa tjetër e stafit nuk lejohen të hyjnë në atë zonë ose të kenë akses ndaj pamjeve.
 - Shkolla vendos në dispozicion pamjet vizive ose të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shtesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevoja hetimi, bazuar në Kodin e Procedures Penale dhe në legjislacionin në fuqi.
 - Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të vidio survejimit ruhen për një periudhë kohore prej 90 ditësh, dhe pas kalimit të kësaj periudhe, të dhënat fshihen.
- ❖ Çdo individ ka te drejtën që të njihet me të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet një kërkesë me shkrim.
- ❖ Çdo person apo subjekt, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndëhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur
- ❖ Për çdo pyetje apo kërkesë rreth kësaj politike mund të kontaktoni në numrin e drejtorisë së shkollës 0692074116, në adresën e –mailit shkolla.elite2017@gmail.com ose në adresën e shkollës Rr.Fuat

Adminstrator

Prof.Asoc.Dr.Jetmir Alicka